




Republika Kosovo
Republika e Kosovës
Republic of Kosovo



Opština Ranilug
Komuna e Ranillugut
Municipality of Ranilug



Në bazë të nenit 12 paragrafi 1 dhe paragrafin 2, pika d), Ligji për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28/2008), Ligji për Shërbyesit Publik Nr. 06/L-114, neni 15, paragrafi 15.1, Statuti i Komunës së Ranillugut nr.02-154/2011, Kuvendi i Komunës së Ranillugut në seancën e pestë të rregullt të mbajtur më 29.07.2022 ka miratuar:

V E N D I M I N P Ë R **KODIN ETIK TË KOMUNËS SË RANILLUGUT**

1.

Propozimi i propozuar kaloi në shqyrtimin kryesor të seancës së pestë të rregullt të Kuvendit të Komunës së Ranillugut të mbajtur më 29.07.2022, ku u lejua dhe u miratua njëzëri.

2.

Me këtë vendim miratohet Kodi i Etikës të Komunës së Ranillugut.

3.

Ky Kod Etike synon të përcaktojë rregullat e sjelljes për kategorinë e punonjësve. Të zhvillojë kulturën organizative të punës në institucion, për të forcuar dhe promovuar parimet bazë dhe standardet më të larta etike në komunë, për të ruajtur afirmimin dhe ngritjen e dinjitetit dhe imazhit të zyrtarëve publikë, gjë që do të ndikojë në rritjen e besimit të qytetarëve në punën dhe funksionimin e komunës së Ranillugut.

4.

Pjesë përbërëse e këtij vendimi nga pika 2 është Kodi i Etikës i Komunës së Ranillugut dhe Deklarata mbi pranimin.

5.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Zyra e Kryetarit të Komunës së Ranillugut dhe Drejtoria për Administratë të Përgjithshme të Komunës.

6.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Kuvendi Komunal.

Datë: 29.07.2022.

Ranillug

Përktheu: Lazim Bajrami



Kryesuesi i K.K të Ranillugut

Ivan Krstiq